

Statut

Ne kete statut

- “Ligji “eshte Ligji Nr. 9901, dt .14.04.2008 “ Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare”.
- “Statuti” eshte Statuti i shoqerise.

Kreu I

Themelimi, Emri, Objekti, Kohezgjatja, Selia.

Neni 1:

Data e Themelimit, Emri dhe Themeluesi

- (1) Sot, me (16.02.2024), une, themeluesi Astrit Caka, kam krijuar nje shoqeri me perjegjesi te kufizuar me emrin **“SHERBIME TAKSI CAKA”**
- (2) Themeluesi i shoqerise eshte :
 - Astrit Caka, datelindjes 24.10.1986, me numer identiteti I61024021U

Neni 2 :

Objekti :

Shoqeria do te kryeje aktivitetin e meposhtem:

Sherbim taksi

Neni 3:

Kohezgjatja

Kohezgjatja e shoqerise do te jetë e papercaktuar :

Neni 4:

Selia.

- (1) Selia e shoqerise ndodhet ne adresen : Rruga. “Ibrahim Braja”, nr.8 Tirane, targa e automjetit AB722NA
- (2) Adresa e shoqerise per qellime komunikimi elektronike eshte si vijon:
ashacaka@gmail.com

Kreu II

Kapitali

Neni 5

Kapitali themeltar

(1) Kapitali themeltar fillestar I shoqerise eshte 10 000 leke . Pjesemarrja e themeluesve ne kapitalin e shoqerise eshte ne perputhje me kontributet e tyre te meposhtme:

1. Ortaku I vetem themelues : Zoterues i 1 (nje) kuote me vlore te pergjithshme qe perben

Neni 6:**Zmadhimi dhe zvogelimi I kapitalit.**

Kapitali i shoqerise mund te zmadhohet nepermjet nenshkrimeve te pjeseve te kapitalit themeltare per kontributet ne para dhe me ane te kontributeve ne natyre, nepermjet emerimit nga gjykata kompetente e nje eksperti te autorizuar per keto kontribute sipas kerkeses se administratorit.

Ne asnjë rast shumica nuk mund te detyroje një ortak per te rritur angazhimin e tij ne kapitalin themeltar te shoqerise.

Zvogelimi i kapitalit lejohet nga asambleja e ortakeve, e cila merr vendim ne te njejtat kushte qe kerkohen per ndryshimin e statutit.

Ne te gjitha rastet zvogelimi i prek ortaket ne te njejen mase ndaj pjeseve te kapitalit qe perfaqesojne.

Neni 7 :**Transferimi I kapitalit**

Kuotat e kapitalit te nje shoqerie me pergjegjesi te kufizuar e te drejtat qe rrjedhin prej tyre mund te fitohen apo kalohen nepermjet :

- a) Kontributit ne kapitalin e shoqerise.**
- b) Shitblerjes.**
- c) Trashegimise.**
- d) Dhurimit.**
- e) Cdo menyre tjeter te parashikuar me ligj.**

Pjeset e kapitalit themeltar jane lirisht te transferueshme ndermjet ortakeve, per sa nuk parashikohet ndryshe ne statut.

Pjeset e kapitalit themeltar jane lirisht te transferueshme me rruge trashegimie.

KREU III**ORGANET VENDIMARRESE DHE DREJTUESE****Neni 8.****Organ Vendmarres:**

Asambleja e Ortakeve eshte organi i vetem vendimarres i shoqerise.

Asambleja e Ortakeve eshte organi i vetem vendimarres i shoqerise qe miraton cdo ndryshim te statutit sipas modalitetete te percaktuar ne ligj.

Asambleja e per gjithshme e ortakeve eshte per gjegjese per marrjen e vendimeve per shoqerine per ceshtjet e me poshtme:

- a) percaktimin e politikave tregtare te shoqerise.
- b) ndryshimin e statutit.
- c) emerimin e shkarkimin e administratoreve.
- ç) emerimi dhe shkarkimi I likujduesve dhe te eksperteve kontabel te autorizuar.
- d) percaktimin e shperblimeve per personat e permendur ne shkronjat "c" dhe "ç" te kesaj pike.
- dh) mbikqyrjen e zbatimit te politikave tregtare nga administratoret, perfshire per gatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe te raporteve te ecurise se veprimtarise.
- e) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe te raporteve te ecurise se veprimtarise.
- ë) zmadhimin dhe zvogelimin e kapitalit.
- f) pjestimin e kuotave dhe anulimin e tyre.
- g) perfaqesimin e shoqerise ne gjykate dhe ne procedimin e tjera ndaj administrates.
- gj) riorganizimin dhe prishjen e shoqerise.
- h) miratimin e rregullave proceduriale te mbledhjeve te asamblese.
- i) ceshtje te tjera te parashikuara nga ligji apo statuti.

Ortaku mund te perfaqesohet ne asamblene e per gjithshme, ne baze te nje autorizimi nga nje ortake tjeter apo nga nje person i trete.

Administratori mund te jepet vetem per nje mbledhje te asamblese se per gjithshme, e cila perfshire edhe mbledhjet vijuese me te njejtin rend dite.

Neni 9

Menyra e thirrjes se mbledhjes se Asamblese se Pergjithshme.

Asambleja e per gjithshme thirret nepermjet nje njoftimi me shkrese ose nese parashikohet nga statute, me njoftim nepermjet postes elektronike. Njoftimi me shkrese apo me mesazh elektronik duhet te permbaje vendin, daten, oren e mbledhjes dhe rendin e dites e t'u dergohet te gjithe ortakeve, jo me vone se 7 dite perpara dates se parashikuar per mbledhjen e asamblese.

Kur asambleja e per gjithshme nuk eshte thirrur sipas pikes 1 te ketij neni, ajo mund te marr vendime te vlefshme vetem nese te gjithe ortaket jane dakort, per te marr vendime, pavaresisht parregullsise.

Neni 10

Kuorumi

Ne rastin e marrjes se vendimeve, qe kerkojne nje shumice te zakonshme, asambleja e per gjithshme mund te marre vendime te vlefshme vetem nese marrin pjese ortaket me te drejte vote, qe zoterojne 30 per qind te kuotave.

Ne rastin kur asambleja e per gjithshme duhet te vendose per ceshtje, te cilat kerkojne shumice te kualifikuar sipas nenit 87 te ligjit “ Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare”, ajo mund te marr vendime te vlefshme vetem , nese ortaket qe zoterojne me shume se gjysmen e numrit total te votive, jane te pranishem personalisht, votojne me shkresë, apo mjet elektronike, sipas parashikimeve te pikes 3 te nenit 88 te ketij ligji.

Nese asambleja e per gjithshme nuk mund te mblidhet per shkak te mungesës se kuorumi te permendur me larte, asambleja mblidhet perseri jo me vone se 30 dite, me te njejtë rend dite.

Neni 11

Marrja e vendimeve.

Asambleja e per gjithshme vendos me tri te katertat e votave te zoteruesve te kapitalit, te ortakeve pjesemarres, per ndryshimin e statutit, zmadhimin ose zvogelimin e kapitalit te regjistruar, shperndarjen e fitimeve, riorganizimin dhe prishjen e shoqerise.

Asambleja e per gjithshme vendos me shumicen e votave te ortakeve pjesemarres, per ceshtje te tjera si:

- a) Percaktimi I politikave tregtare te shoqerise.**
- b) Emerimin dhe shkarkimin e administratoreve.**
- c) Emerimin e shkarkimin i likujdusve dhe eksperteve kontabel te autorizuar.**
- d) Percaktimin e shperblimeve.**
- e) Mbikeqyrjen e zbatimit te politikave tregtare nga administartoret, perfshire per gatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe te raporteve te ecurise se veprimtarise.**
- f) Perfaqesimin e shoqerise ne gjykate dhe ne procedimet e tjera ndaj administratoreve.**
- g) Miratimin e rregullave procedurale te mbledhjeve te asamblese.**

Cdo ndryshim statiti duhet te depozitohet prane QKR per te pasqyruar ndryshimet ne skeden e shoqerise.

Neni 12

Perjashtimi nga e drejta e votes.

1. Ortaku mund te ushtroje te drejtene e votes nese asambleja e per gjithshme merr vendim per:
 - a) Vleresimin e veprimtarise se tij.**
 - b) Shuarjen e ndonje detyrimi ne ngarkim te tij.**
 - c) Ngritjene e nje padie ndaj tij nga shoqeria.**
 - d) Dhenien ose jo te perfitimeve te reja.**
2. Kur ortaku perfaqesohet nga nje perfaqesues i autorizuar, i autorizuari vleresohet te jete ne te njejin konflikt interes, ashtu si dhe ortaku, te cilin perfaqeson.

Neni 13

Administrimi

1. Asambleja e pergjithshme emeron nje ose me shume persona fizike si administratore te shoqerise. Afati i emerimit, eshte 5 vjet, me te drejte riperteritjeje. Emertimi i administratoreve prodhon efekte pas regjistrimit ne Qendren Kombetare te Regjistrimit.
2. Administratoret e nje shoqerie tregtare meme, sipas percaktimit te nenit 270 te ketij ligji, nuk mund te emerohen si adminstratore te nje shoqerie te kontrolluar e anasjelltas. Cdo emerim i bere ne kundershtim me keto dispozita eshte i pavlefshem.
3. Personat e meposhtem caktohen si Administratore te pare te shoqerise deri ne emerimin e tyre nga mbledhja e pare e Asamblese se Pergjithshme.

Te dhenat e identifikimit:

(emer mbiemri):

- Astrit Caka

Neni14

Kompetencat e Administratoreve

Administaratoret kane te drejte e detyrohen te:

- a) **Kryejne te gjitha veprimet e adminstrimit te veprimtarise tregtare te shoqerise, duke zbatuar politikat tregtare, te vendosura nga asambleja e pergjithshme.**
- b) **Perfaqesojne shoquerine tregtare.**
- c) **Kujdesen per mbajtjen e sakte e te rregullt te dokumnteve dhe te librave kontabel te shoqerise.**
- d) **Pergatisin dhe nenshkruajne bilancin vjetore, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurise se veprimtarise dhe, se bashku me propozomet e fitimeve, i paraqisin keto dokumente perpara asamblese se pergjithshme per miratim.**
- e) **Krijojne nje system paralajmerimi ne kohen e duhur per rrethanat, qe kercenojne mbarevajtjen e veprimtarise dhe egzistencen e shoqerise.**
- f) **Kryejne regjistre dhe dergojne te dhenat e detyrueshme te shoqerise, sic parashikohet ne ligjin per Qendren Kombetare te Regjistrimit.**
- g) **Raportojne perpara asamblese se pergjithshme ne lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimtarive te posacme me rendesi te vecante per veprimtarine e shoqerise tregtare.**
- h) **Kryejne detyra te tjera te percaktuara ne ligj dhe statut.**

Administratoret jane te detyruar te therrasin Asamblene e Pergjithshme, ne rastet kur:

- Sipas bilancit vjetor apo raporteve te ndermejtme financiare, rezulton ose egziston reziku qe aktivet e shoqerise nuk i mbulojne detyrimet e kerkueshme brenda 3 muajve ne vazhdim.

- Shoqeria propozon te shese apo te disponoje ne menyre tjeter aktive, te cilat kane nje vlere me te larte se 5 per qind te aseteve te shoqerise, qe rezulton ne pasqyrat e fundit financiare te certifikuara.
- Shoqeria, brenda 2 viteve te para pas regjistrimit te saj, propozon te bleje nga nje ortak pasuri, qe kane vlere me te larte se 5 per qind te aseteve te shoqerise, qe rezulton ne pasqyrat e fundit financiare te certifikuara.

Nese asambleja e per gjithshme emeron me shume se nje administrator, ata e administrojne bashkerisht shoqerine.

Asambleja e Pergjithshme mund te shkarkoje administratorin ne cdo kohe me shumice te zakonshme. Padite, qe lidhen me shperblimin e administartorit, ne baze te mardhenieve kontraktore te shoqerise, rregullohen sipas dispozitave ligjore ne fuqi.

Neni 15

Pergjegjesite e Administratorit.

Administratori eshte per gjegjes individualisht, ndaj shoqerise ose ndaj te treteve, per shkelje te ligjeve, per shkelje te statutit, apo pe faje te kryera gjate adminstrimit te shoqerise.

Pasojat e marreveshjeve te pamerituara nga asambleja qe i sjellin dem shoqerise, i ngarkohen administratorit dhe ortakut qe ka bere marrveshjen, per te perballuar ne menyre individuale ose solidarisht sipas rastit pasojat perkatese.

Pervec sa eshte parashikuar ne dispozitat e per gjithshme te detyrimit te besnikerise, sipas neneve 14, 15, 17, 18 te ligjit “ Per Tregtaret dhe Shoqerie Tregtare”, administrator detyrohet.

1. a) te kryeje detyrat e tij te percaktuara ne ligj dhe ne statut ne mirebesim dhe ne interesin me te mire te shoqerise ne teresi, duke i kushtuar vemendje te vecante ndikimit te veprimtarise se shoqerise ne mjesdis.
b) te ushtroje kompetencat qe i njeh ligji dhe ne statut vetem per arritjen e qellimeve te percaktuara ne keto dispozita.
c) te vleresoje me per gjegjesi ceshtjet, per te cilat merret vendim.
d) te parandaloje dhe menjanoje rastet e konfliktit, present apo te mundshem, te interesave personale me ate te shoqerise.
dh) te ushtroje detyrat e tij me profesionalizmin dhe kujdesjen e nevojshem.
2. Administratori, gjate kryerjes se detyrave te tij, per gjigjen ndaj shoqerise per cdo veprim ose mosveprim, qe lidhet ne menyre te arsyeshme me qellimet e shoqerise tregtare, me perjashtim te rasteve kur, ne baze te hetimit dhe vleresimit te informacioneve perkatese, veprimi ose mosveprimi eshte kryer ne mirebesim.
3. Nese administrator vepron ne kundershtim me detyrat dhe shkel standartet profesionale, sipas pikave 1 dhe 2 te ketij neni, eshte i detyruar t'i demshperbleje shoqerise demet, qe rrjedhin nga kryerja e shkeljes, si dhe t'i kaloj cdo fitim personal qe ata apo personat e lidhur me ta kane realizuar nga keto veprime te parregullta. Administratori ka barren e proves per te vertetuar kryerjen e detyrave te tyre ne

menyre te rregullt e sipas standarteve te kerkuara. Kur shkelja eshte kryer nga me shume se një administrator, ata per gjigjen ndaj shoqerise ne menyre solidare.

4. Ne menyre te vecante, por pa u kufizuar ne to, administratori eshte i detyruar t'i demshperblej shoqerise demte e shkatuara, ne kundershtim me dispozitat e ligjit ““ Per Tregtaret e Shoqerit Tregtare”, kryen veprimet e meposhtme.
 - a) U kthen ortakeve kontributet.
 - b) U paguan ortakeve interesat apo dividente.
 - c) U shperndan aktive shoqerise.
 - d) Lejon qe shoqeria te vazhdoje veprimtarine tregtare, kur ne baze te gjendjes financiare duhet te parashikohej qe shoqeria nuk do te kishte aftesi paguese per te shlyer detyrimet.
 - e) Jep kredi.

Pervec padise per shlyerjen e demit qe i ngarkohet personalisht adminstratorit, ortaket individualisht ose se bashku, kane te drejte te ngrene padi penale kunder adminstratorit.

Paditesit kane te drejte te ndjekin ne rruge ligjore shlyerjen e plote te demit qe i eshte shkaktuar shoqerise, perfshire edhe demshperblimet financiare, nese eshte e nevojshme. Asnjeh vendim i asamblese nuk mund te ndaloje ngritjen e kerkese padise kunder adminstratorit per gabimet ekryera prej tij gjate ushtrimit te detyres.

Kreu IV

Viti finanziar- ekspertet.

Neni 16

Viti Financiar.

Viti finanziar i Shoqerise fillon me 1 Janar dhe perfundon me 31 Dhjetor. Perjashtmisht, viti i pare finanziar fillon nga data e rregjistrimit te shoqerise ne Qendren Kombetare te Regjistrimit dhe mbyllt me 31 Dhjetor.

Neni 17

Ekspertet.

Eksperti ka per te detyre qe te kontrolloje te gjithe dokumentacionin kontabel te veprimtarise ekonomike tregtare te shoqerise, ate gjithevetor dhe ate ne lidhje me kontrollet periodike te ushtruar prej tij per ratet kur ai eshte i ngarkuar dhe ka kryer nje gje te tille i ngarkuar nga ana e ortakeve.

Ne perfundim te kontrollit eksperti kontabel i autorizuar percatit raportin me shkrim per nxjerrjen e rezultatit te bilancit vjetor si dhe ate per kontrollet periodike te ushtruara, te cilat eshte i detyruara t'ja paraqes e dorezoje ne kohe ortakeve per ti shqyrtuar e miratuar mbi bazen e te drejtes vendimore qe ka.

Kreu

Prishja – riorganizimi i shoqerise

Neni 18

Prishja dhe likuidimi.

Shperndarja ose prishja e shoqerise mund te behet ne cdo kohe :

- a) Kur mbaron kohezgjatja e parashikuar ne themelin e saj.
- b) Me vendim te Asamblese se Ortakeve.
- c) Me hapjen e procedurave te falimentimit.
- d) Nese nuk ka kryer veprimitari tregtare per dy vjet dhe nuk eshte njoftuar pezullimi I veprimitarise ne perputhjen me piken 3 te nenit 43 te ligjit nr. 9723, date 03.05.2007, “ Per Qendren Kombetare te Regjistrimit”.
- e) Me vendim te Gjykates.

Ne kete rast Ortaket marrin vendim me shkrim ne te cilin parashikojn menyren e likujdimit te shoqerise, duke caktuar nje ose disa likuidator dhe shenuar ne cdo document te nxjerr prej tij emrin e likidatorit dhe emertesen shtese “ Shoqeria ne likuidim e siper “.

Prishja e shoqerise tregtare ka si pasoje hapjene procedurave te likuidimit ne gjendjen e aftesise paguese, me perjashtim te rasteve kur eshte nisur nje procedure falimentimi.

Likujdimi kryhet nga likuiduesit e emeruar nga Ortaket.

Nese Ortaket nuk marrin nje vendim per emerimin e likuiduesve, Brenda 30 diteve pas prishjes, cdo person I interesuar mund t’I drejtohet gjykates, per te percaktuar nje likuidues.

Neni 19

Riorganizimi I shoqerise bashkimi-ndarja.

Shoqeria mund te ndahet, bashkohet sipas Vendimit te Mbledhjes se Pergjithshme te Asambles se Ortakeve, ne perputhje me dispozitat ligjore te parashikuara ne Pjesen IX te ligjit 9901, date 14.04.2012, “ Per Tregtaret dhe Shoqerit Tregtare”.

Neni 20

Baza ligjore.

Shoqeria do te zhvilloj aktivitetin e tij ne perputhje te plote me kete statut dhe dispozitat e legjisacionit shqiptare.

Per sa nuk parashikohet ne kete statut, do te zbatohet dispozitat e ligjit “ Per Tregtaret dhe Shoqerit Tregtare”, Kodit Civil dhe cfardo ligji tjeter specific ne Republiken e Shqiperise.

**Neni 21
Mosmarrveshjet.**

Per mosvarrveshjet qe mund te lindin ne lidhje me zbatimin apo intepretimin e ketij statuti, si dhe per cdo mosmarrveshje qe mund te lind midis Shoqerise dhe te treteve, do te jetë kompetent Gjykata Shqiptare.

O R T A K I V E T E M

**I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR
“SHERBIME TAKSI CAKA”**

ASTRIT CAKA

